



Donor
Fondi Ekologjik Global
Organizata për Zhvillimin
e Industrisë e Kombeve të
Bashkuara
(UNIDO)

Vlera e plotë e projektit
USD 520,000

Kohëzgjatja
Maj 2015 – Qershor 2021

Vendi shfrytëzues
Republika e Maqedonisë së
Veriut

Kontakt
cmldu@rec.org

Nxitja e transformimit të tregut për efikasitetin energjetik në industri dhe përsheptimi i investimeve në praktikat dhe teknologjitë më të mira

Projekti përqendrohet mbi barrierat ekzistuese për efikasitetin energjetik në sektorin industrial maqedonas përmes qasjes së integruar që ndërthur ndërtimin e kapaciteteve me ndihmën e synuar teknike në nivelin e politikës, tregut dhe zbatimit të efikasitetit energjetik. REC bashkëpunon me institucionet publike, përfshirë Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, Ministrinë e Ekonomisë, Agjencinë e Energjetikës dhe Bankën Zhvillimore të Maqedonisë së Veriut, si dhe me sektorin privat.



QËLLIMET

Projekti kontribuon në përshpejtimin e transformimit të tregut maqedonas në efikasitetin e energjisë industriale në rritjen e përdorimit dhe kërkesës për praktikata dhe teknologjitë më të mira në dispozicion, të tilla si sistemet e menaxhimit të energjisë në përputhje me ISO 50001, dhe zgjedhja më e madhe e shërbimeve të ndërlidhura konsultante. Gjatë projektit, parashikohen zvogëlime vjetore të emisioneve të gazrave serë prej 133,000 ton CO₂eq.

Qëllimet janë:

- forcimi i politikës maqedonase, korniza rregulatore dhe institucionale dhe kapaciteti për transformimin e tregut për efikasitetin energjetik industrial dhe industria e gjelbër;
- zhvillimi i tregut për vendosjen dhe shpërndarjen e praktikave dhe teknologjive më të mira në dispozicion për efikasitetin energjetik dhe qëndrueshmëria e mjedisit jetësor në industri; dhe
- rritja e investimeve në teknologjitë për efikasitetin energjetik në industri

AKTIVITETET

Projekti është i ndarë në 3 komponentë:

- Komponenti 1 – Forcimi i politikave dhe institucioneve
- Komponenti 2 – Shërbimet e tregut, aftësitë dhe zbatimi
- Komponenti 3 – Rritja e investimeve

Komponenti 1 Programi i politikës së menaxhimit të energjisë, i cili përfshin certifikimin e personelit të menaxhimit të energjisë në rast të konsumatorëve të mëdhenj të energjisë; stimulimet për zbatimin e sistemit të menaxhimit të energjisë; shpërndarja e informatave mbi praktikatat më të mira dhe efikasitetin e energjisë industriale (EEI). Ky komponent, gjithashtu, përqendrohet në përdorimin e mjetit industrial për menaxhimin e të dhënave energjetike; vlerësimi i teknologjive klimatike për industrinë; dhe forcimi i ekspertizës institucionale të EEI-së.

Komponenti 2 Zbaton trajnime për konsulentët e EEI-së në përputhje me standardin ISO 50001; optimizimi i sistemeve të kondensimit (SSO); dhe optimizimi i sistemeve të ajrit të kompresuar në industri (CASO). Aftësitë e reja të konsulentëve do t'u ndihmojnë kompanive partnere t'i identifikojnë dhe zbatojnë masat e EEI-së. Bashkëpunimi midis konsulentëve dhe ndërmarrjeve partnere zhvillohet në të ashtuquajturat ekipet e menaxhimit të energjisë, të cilat marrin pjesë në programet njëvjeçare të ndërtimit të kapaciteteve të menaxhimit të energjisë.

Komponenti 3 siguron ndihmë teknike për përgatitjen dhe vlerësimin e propozimit për investimet në EEI; premia e parave të gatshme të bazuar në performancat e investimeve të EEI-së; trajnimi i konsulentëve lokalë të EEI-së; dhe trajnimi i operatorëve të huave në bankat maqedonase.



UNITED NATIONS
INDUSTRIAL DEVELOPMENT ORGANIZATION



GLOBAL ENVIRONMENT FACILITY
INVESTING IN OUR PLANET



REGIONAL ENVIRONMENTAL CENTER